



ENERGY '23

EXPO & FORUM | EDICIONI 5^{TÈ}

MARS 2023 29-31

TË GJITHË SYTË NGA ENERGJIA!

DATË 29-31 MARS 2023

Në datat 29-31 Mars 2023, Expocity Albania organizon Edicionin e 5-të të Panairit dhe Forumit Ndërkombëtar të Energjisë.

“Mundësi në vorbullën e krizës”: Energy Expo & Forum 2023 do të trajtojë situatën aktuale të sektorit të energjisë, krizën në të cilën ndodhet sot bota, ndaj të cilës nuk është imune as Shqipëria.

Ekonomistët botërorë e kanë cilësuar këtë një moment kulminant që do të formësojë të ardhmen e energjisë duke e bërë këtë sektor më fleksibël ndaj goditjeve, më të larmishëm dhe ku roli i burimeve të rinovueshme do të jetë thelbësor.



Energy Expo & Forum 2023 ka në fokus politikat energjetike dhe aspektet ligjore në Shqipëri dhe rajon, orientimin dhe konsolidimin e planit kombëtar të energjisë, sfidat e bashkëpunimit rajonal të tregjeve, risitë, skemat mbështetëse që ofrohen nga qeveritë për promovimin e investimeve në këtë fushë, efikasitetin e përdorimit të energjisë; planifikimin ekologjik; zhvillimet klimatike; tregun dhe aktorët e tij; teknologjinë e ndërtimit në funksion të ruajtjes së energjisë; trajtimin e hidrokarbureve, investimet në naftë dhe gaz; riciklimin; informacionet për të rejtat e procedurave dhe legjislacionit, bursën e energjisë, etj. Edhe në këtë edicion, energjia e rinovueshme do të jetë temë kryesore. Synimi është diversifikimi i burimeve të energjisë, rritja e sigurisë së furnizimit dhe zvogëlimi i importeve.



EDICIONI I 5-TË ENERGY EXPO & FORUM 2023:

- Do të nxisë bizneset dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve të rëndësishëm në fushën e energjisë, mbrojtjes së mjedisit, ndërtimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri dhe në rajon.
- Do të informojë dhe orientojë investitorët e mundshëm për projektet potenciale të investimeve në sektorin e energjisë si dhe ndryshimet në legjislacion dhe përfitimet prej tyre.
- Do të krijojë mundësinë për paraqitjen e teknologjisë më të avancuar dhe format e disponueshme të financimit të projekteve të energjisë.
- Do të nxisë përdorimin dhe shfrytëzimin më të madh të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe marrjen e masave për efikasitetin e energjisë.
- Do të kontribuojë në ndërgjegjësimin për ndërtimin ekologjik të objekteve.
- Do të ndihmojë në zbatimin e Partneriteteve Publike-Private në Shqipëri dhe në rajon.

PJESËMARRËSIT NË ENERGY EXPO do të mbulojnë fushat si më poshtë:

Prodhimi i energjisë me teknologjinë diellore | Të erës | Hidro Gjeotermike | Gazit | Transmetimi i energjisë, transformatorët | Linjat e energjisë, ingranazhet për shpërndarjen e energjisë, zgjidhjet e teknologjisë së ndriçimit diellor | Led tech | Zgjidhje të kombinuara, teknologjia e lidhur me energjinë hidrike, turbinat | Sistemet e tubave, teknologjia e kursimit të energjisë, bankat, institucionet financiare dhe projektet e tyre në fushën e energjisë.

Shoqëritë e shërbimeve publike ERE | OST | OSHEE | KESH | Albagaz | AKBN, ALPEX, projektet e mëdha të energjisë, të tjerë, koncesionet e reja | Projekte smart dhe ekologjike, zgjidhje për ruajtjen e energjisë, aksesore për energji sa më efiçente për konsumatorët.



PSE DUHET TË MERRNI PJESË NË ENERGY EXPO & FORUM 2023

Panairi synon të sigurojë takime dhe diskutime midis të gjithë aktorëve të energjisë dhe zhvillim lokal në të gjithë rajonin, për të nxitur investime më të mëdha dhe për të rritur konkurrencën. Gjithashtu, synohet të nxitet zhvillimi i marrëveshjeve të biznesit dhe partneriteteve gjatë këtyre tre ditëve, jo vetëm me shoqëritë kryesore në treg, por edhe me shoqëri të reja të interesuara në tregun rajonal; takime B2B, B2G dhe B2C; tryeza të rumbullakta bashkëbisedimi me aktorë kryesorë; workshop-e informues nga shoqëri të rëndësishme në treg etj., si dhe nga fusha e infrastrukturës; ekonomistë në fushën e energjisë, etj.

NË KATËR EDICIONET E MËPARSHME TË ENERGY EXPO & FORUM :

Morën pjesë mbi 500 biznese ekspozuese nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Italia, Gjermania, Greqia, Franca, Kina, Austria, Zvicra etj;

Ishin prezent mbi 10,000 vizitorë, kryesisht profesionistë në sektorin e energjisë;

U mbajtën mbi 100 forume nga më shumë sesa 200 studiuës dhe ligjvënës të sektorit kryesisht për:

- Energjitë e gjelbërta, efiçenca e energjisë, digjitalizimi;
- Bursa e Energjisë;
- Asistenca dhe mbështetja e sektorit të energjitikës nga Bashkimi Europian për Shqipërinë dhe Rajonin;
- Sektori Energjitik dhe Banka;
- Politika e diversifikimit të burimeve të rinovueshme në Shqipëri dhe rajon;
- Energjia e Erës në Shqipëri dhe rajon, investimet dhe interesat etj;



Expocity Albania është organizues i Panairove dhe Konferencave Kombëtare dhe Ndërkombëtare, i çertifikuar nga UFI, specializuar në organizimin dhe zhvillimin e panairove, ekspozitave dhe eventeve të ndryshme të biznesit, drejtuar tregut vendor dhe atij ndërkombëtar.

Expocity Albania ju ofron pjesëmarrësve në këto aktivitete një strukturë dhe infrastrukturë të plotë, bashkëkohore dhe të plotësuar me të gjitha lehtësitë dhe stafin e nevojshëm.

Këto bashkë me 5'000 m² hapësirë të brendshme, 7'000 m² hapësirë të jashtme, e plotësojnë Expocity Albania si platformën më komplekse dhe më të përshtatshme për realizimin me sukses të këtij lloj komunikimi në Shqipëri.



EXPOCITY ALBANIA Autostrada Tiranë-Durrës, km 8^{të}, Tirana, Albania
Cel: + 355 67 404 9193 | e-mail: ana.islamaj@expocity.al
Cel: + 355 67 770 0077 | e-mail: info@expocity.al, Web: www.expocity.al